



**USAID**  
FROM THE AMERICAN PEOPLE

**СТУДИОРУМ**  
Center for Regional Policy Research and Cooperation

## LAJMËRIM PËR SHTYPIN

### **USAID e lëshoi botimin e 15-të të Indeksit të qëndrueshmërisë së organizatave qytetare të Evropës Qendrore e Lindore e të Euroazisë**

Uashington, SHBA – Agjencia e Zhvillimit Ndërkombëtar të Steve të Bashkuara të Amerikës (USAID) e lëshoi botimin e 15-të të Indeksit të qëndrueshmërisë së organizatave joqeveritare, para pak kohë është riemëruar në Indeks të qëndrueshmërisë së organizatave qytetare, në drejtim të njohjes së spektrit të gjerë të organizatave joprofitabile qytetare (OQ) që janë aktiv në rajon. Botimi i këtij viti i referohet zhvillimit të shoqërisë qytetare në vitin 2011. Indeksi e ndjek zhvillimin e sektorit qytetar në njëzet e nëntë shtete gjatë pesëmbëdhjetë vitet e fundit. I njëjti e shqyrton mjedisin në të cilin veprojnë OQ, me fokus mbi mjedisin juridik, kapacitetin organizues, qëndrueshmërinë financiare, përfaqësimin, sigurimin e shërbimeve, infrastrukturën dhe imazhin në publik.

Ndrushimet e qëndrueshmërisë së sektorit qytetar në vitin 2011 e reflektojnë situatën e plotë negative ekonomike në kornizat globale. Ndikim të rëndësishëm mbi mundësitë e OQ-së kanë edhe ngjarjet politike, si në vend, ashtu edhe në nivel ndërkombëtar. Në shumë vende, viti 2011 ishte viti i zgjedhjeve që sidoqoftë ndikon mbi mjedisin në të cilin veprojnë OQ. Në të njëjtën kohë, vetë organizatat qytetare luajnë rol të rëndësishëm në zgjedhjet, përmes ndikimit të kandidatëve për adresimin e çështjeve të rëndësishme, edukimin e votuesve dhe mbikëqyrje të zgjedhjeve. Në nivel global, Unioni Evropian vazhdon të jetë faktor i rëndësishëm në rajon, veçanërisht në shtetet me të cilat kanë filluar negociacionet për anëtarimin, që u jep OQ-ve më shumë mundësi për ndikim dhe investim në politikat e zbatuara.

Pa dallim a bëhet fjalë për përmbytjet në Azerbejxhan, sigurimin e ndihmës juridike dhe përkrahje për përfundimin e femrave në Bosnjë e Hercegovinë, përfundimin e mbrojtjes shëndetësore në Tashkistan apo për përkrahjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në Rusi, OQ-të nga rajoni i Evropës apo i Euroazisë përfshihen në përfilljen e sfidave me të cilat përballohen vendet e tyre.

Në promovimin e këtij botim më të ri të indeksit të qëndrueshmërisë së OQ-ve, ndihmës drejtorja e USAID për Evropë dhe Euroazi, Pejxh Aleksandri i tregoi përshëndetjet e saj të sinqerta ndaj një aritjeje të këtijloje siç është edhe botimi i këtij mjeti të rëndësishëm analitik gjatë pesëmbëdhjetë viteve. Indeksi i qëndrueshmërisë së OQ-së përjetoj transformim drastik nga fillimi i tij – me zgjerimin nga 21 vende në rajonin e Evropës dhe Euroazisë, në më shumë se 60 vende të rajoneve të ndryshme në tërë botën. Qendra për hulumtime dhe bashkëpunim rajonal “Studiorum” me kënaqësi e pranoi bashkëpunimin me USAID për përgatitjen e indeksit të Republikës së Maqedonisë.

Versioni integral të raportit mund ta gjeni në (gjuhë angleze):

[http://transition.usaid.gov/locations/europe\\_eurasia/dem\\_gov/ngoindex/](http://transition.usaid.gov/locations/europe_eurasia/dem_gov/ngoindex/).

Më shumë informata rreth programeve të USAID: [www.usaid.gov/](http://www.usaid.gov/).

*Populli amerikan, përmes Agjencisë së SHBA-së për zhvillim ndërkombëtar, siguron ndihmë ekonomike dhe humanitare në tërë botën pothuajse 50 vjet.*